



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA FUSHE-ARREZ

KESHILLI

Nr. 2147 prot.

Fushe-Arrez, me 04.07 2024

VENDIM

NR.28 DATE 27.06.2024

“PER MOSDHENIEN E DAKORTESISE PER KERKESEN E SHOQERISE RAJONALE TE UJESJELLES KANALIZIME SHKODER PER NDRYSHIMIN E NIVELIT TE TARIFAVE PER SHERBIMIN E FURNIZIMIT ME UJE TE PIJSHEM DHE LARGIMIN E UJERAVE TE NDOTURA”.

Ne mbështetje të nenit 13,14,21 dhe 22 të ligjit nr.8102 date 28.03.1996 “Per kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e perpunimit të ujerave të ndotura”, I ndryshuar (ligji nr.8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539 date 30.12.2021 “Per miratimin e metodologjise dhe procedures per miratimin e tarifave të shërbimeve ujesjelles kanalizime” (Vendim KKRR nr.539), ne zbatim të Ligjit nr.9901, date 14.04.2008, “Per shoqëritë tregtare” dhe VKM Nr.302, date 11.05.2022 “Politikat kombetare per riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit të ujerave të ndotura”, Keshilli i Bashkise ne mbledhjen e dates 27.06.2024, pasi u njoh me kërkesen e Shoqërisë Rajonale Ujesjelles Kanalizime Shkoder SH.A “ Per shprehjen e mendimit ne lidhje me ndryshimin e nivelit të tarifave per shërbimin e furnizimit me ujë të pijshem dhe largimin e ujerave të ndotura” , i drejtuar Keshillit Bashkiak Fushe-Arrez, shkresa me Nr.1842 Prot.,date 10.06.2024, dhe materialet bashkelidhur ketij propozimi :

VENDOSI

- Te shprehet kunder kërkeses të bere nga Shoqëria Rajonale Ujesjelles- Kanalizime Shkoder per ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshem dhe largimit të ujerave të ndotura per vitet 2025-2027 per Njesine Fushe-Arrez, sipas tabelës bashkelidhur kërkeses:

36

Kategoria e Klienteve		Tarifat Aktuale	Tarifat e Propozuara Per Vitet 2025-2027
A.Sherbimi I Furnizimit me Uje		Lek/m ³	Lek/m ³
Njesia Fushe - Arrez	1.Konsumatore Familjare	20	60
	2.Konsumatore Publik	80	120
	3.Konsumatore Privat	80	120
B.Sherbimi I Kanalizimeve te Ujerave te Ndotura		Lek/m ³	Lek/m ³
Njesia Fushe- Arrez	1.Konsumatore Familjare	7.5	20
	2.Konsumatore Publik	10	40
	3.Konsumatore Privat	10	40
C.Tarife Fikse Sherbimi		Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje
Njesia Fushe- Arrez	1.Konsumatore Familjare		200
	2.Konsumatore Publik		300
	3.Konsumatore Privat		300

- Ky vendim u miratua me:
Vota pro 8 vota
Vota kuder 0 vota
Vota abstenim 0 vota
- Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise .
- Ky vendim u shpall me daten 04.07.2024 .

Sekretari

Tom CURRI



KRYETARI

Nikolin BARDHOKU

